

**KONTRATË SHITJE KUTASH**  
**TË SHOQËRISË**  
**“STONE KONSTRUKSION” Sh.p.k.**

Në Vlorë, sot më datë 04 NËNTOR 2020 ( dymijë e njëzetë) në selinë e Shoqërisë Stone Konstruksion shpk, u paraqitën personalisht palët në këtë kontratë dhe hartuan këtë kontratë shitje kuotash me këto kushte:

**PALA SHITËSE Z. Florenc Gjiguria**, atësia Milo, shtetas shqiptar, lindur më 12.01.1973 në Memaliaj, Tepelenë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim nr. Personal H30112106D dhe nr.031406006 zotërues i njëqind (100) kuota, që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë “STONE KONSTRUKSION“ Shpk”

*(në vijim do të përmendet si Ortaku Shitës);*

**PALA BLERËSE: Adrian Gjura**, atësia Nikoll, amesia Eleni, shtetas shqiptar, lindur më 17.12.1965 në Krujë dhe banues në Qytet Fushe Kruje; Nd. 005; H. 0; ; Fushëkrujë; Fushë Krujë; 1502; Krujë madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me pasaportë me nr. Personal G51217020D dhe nr.BE8617889

*(në vijim do të përmendet si Ortaku i ri Blerës);*

Palët kontraktuese me marrëveshje midis tyre, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, deklarojnë se kanë rënë dakord që në bazë të besimit reciprok, kushteve aktuale të tregut dhe legjislacionit; Ligjit 9723 datë 03.05.2007 “ Për QKB“ i përditësuar dhe Neni 73, pika 1, gërma “b“ e Ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“; të lidhin këtë Kontratë shitje kuotash, në përputhje me ligjin, si më poshtë vijon:

**Meqënëse:**


- a) Ortaku shitës është zotërues i 100 (njëqind) kuota, që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë “Stone Konstruksion” Sh.p.k. e regjistruar si shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me **NUIS L27322203V**.
- b) Shoqëria “STONE KONSTRUKSION“ Sh.p.k. është një shoqëri rregullisht e regjistruar dhe vlefshmërisht ekzistente sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.
- c) Shoqëria është e lirë nga çdo hipotekim barrë kërkesë ligjore mbi pasurinë, garanci detyrim interesa sigurimi të drejta të personave të tretë ose pretendime të tjera ose çdo lloj barre e tillë.
- d) Palët bien dakort për transferimin e kuotave të kapitalit nga Ortaku shitës tek Ortaku blerës në Shoqëri sipas kushteve dhe afateve të percaktuara në këtë kontratë.
- e) Me nënshkrimin e kësaj kontrate ortaku shitës transferon nëpërmjet shitjes 100 kuota, që përbën 100% të kapitalit të Shoqërisë “STONE KONSTRUKSION” **Sh.p.k.** në favor të ortakut të ri blerës Adrian Gjura.

**1. Përfaqësimet dhe Garancitë e palëve**

Palët këtu përfaqësojnë dhe garantojnë njera tjetrën në këtë datë të kontratës, si më poshtë:

**Autorizimi:** Secila palë ka fuqinë e plotë korporative dhe autoritetin të ekzekutojë dhe kalojë të drejtat me këtë kontratë dhe të gjithë dokumentat e tjera të nevojshme për transaksionin dhe për të përfunduar dhe konsumuar transaksionin e parashikuar në këtë Kontratë. Pjesë përbërëse e kësaj Kontrate do të jenë :

- Vendimi i Asamblese të Ortakut të vetëm të Shoqërisë « STONE KONSTRUKSION“ Sh.p.k., në të cilin lejohet transferimi i kuotave të kapitalit tek Ortaku ri blerës Adrian Gjura.
- Vendimi i Asamblesë të ortakëve të Shoqërisë « STONE KONSTRUKSION» shpk, në të cilën lejohet blerja e kuotave të kapitalit, në masën 100% të Shoqërisë « STONE KONSTRUKSION » shpk.



**Pa konflikt:** ekzekutimi, kalimi i të drejtave dhe permbushja e detyrimeve nga secila Palë e kësaj Kontrate dhe konsumimi nga secila Palë e transaksionit të parashikuar në të, nuk do të duhet të :

- (i) dhunojë, të shkaktojë konflikt me rezultat shkelje nga cilado Palë të ndonjë prej klauzolave të dokumentave të regjistrimit të secilës Palë,
- (ii) dhunojë, të shkaktojë konflikt me rezultat shkelje nga cilado Palë të ndonjë prej klauzolave të ndonjë marrëveshje në të cilën cilado Palë është palë ose çdo detyrim tjetër ligjor ndaj të cilit cilado Palë është e detyruar,
- (iii) dhunojë, të shkaktojë konflikt me rezultat shkelje nga cilado Palë të ndonjë ligji ose urdhërese të çdo autoriteti qeveritar të aplikueshme ndaj cilësdo Palë, ose
- (iv) të kërkojë çdo lloj urdhër material, pëlqim sqarim miratim ose autorizim të/ose ndonjë fërkimi me çdo autoritet qeveritar.

## **2. Kushtet dhe termat e shitjes së kuotave**

2.1 Ortaku shitës do të shes nëpërmjet kësaj kontrate tek Ortaku i ri, blerës 100 kuota, që përbënë 100% të kapitalit të shoqërisë "STONE KONSTRUKSION" shpk, me kushtet dhe termat e shitjes se kuotave si vijon :

- Çmimi i shitjes së 100 kuota që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, është në vlerën **10'000lekë**, vlerë e cila është likjuar totalisht nga blerësi në favor të shitësit
- Blerësi **Adrian Gjura**, deklaron se e ka likjuar vlerën totale të shitjes së kuotave në masën 10'000leke.

2.2 Me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj kontrate në QKB (Qëndrën Kombëtare të Biznesit), ortaku i Shoqërisë "STONE KONSTRUKSION" Sh.p.k. do të jetë si më poshtë:

- **Adrian Gjura**, ortak i shoqërisë, zoteron 100 kuota që përbën 100% të kapitalit të Shoqërisë "Stone Konstruksion" Sh.p.k.

## **3. Garancitë**

Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotave që po transferon, nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga cdo barrë apo pretendim tjetër ligjor, verifikuar sipas vërtetimit nga Regjistri i barrëve siguroese, bashkalidhur.

## **4. Heqja dorë nga të drejtat**

Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se heq dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë nga 100 kuota, që përbën 100% të kapitalit të Shoqërisë « Stone Konstruksion» Sh.p.k., pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

## **5. Konfidencialiteti**



Palët bien dakort që gjithë informacioni, përfshirë pa kufizim informacion teknik apo biznesi, i marrë prej tyre nga njeri tjetri, ngelet i brendshëm dhe konfidencial dhe nuk do të jepet nga ata tek ndonjë palë e tretë .

## **6. Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni**

**Ligji i zbatueshëm:** Kjo Kontrate do t'i nënshtrohet Legjislacionit Shqiptar duke mos i dhënë efekt konfliktit të parimeve ligjore, përkatsisht Ligjit 9723 datë 03.05.2007 " Për QKB" i përditësuar dhe Neni 73, pika 1, gërma "b" e Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

**Juridiksioni:** Gjykata kompetente e Shqipërisë do te kete juridiksionin per te zgjidhur çdo mosmarreveshje qe mund te linde nga ose ne lidhje me kete Kontrate siç siperpermendet, dhe Palët bien dakort t'i nënshtrohen një juridiksioni të tillë.

## **7. Të ndryshme**

**Amendamentet.** Asnje shtese ose ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete detyrues ndaj seciles Pale nese nuk eshte me shkrim dhe ekzekutuar sipas rregullave prej Paleve ne te, ne te njejten menyre si ne ekzekutimin e Kontrates.

**Adresa :** Çdo njoftim që do të lëshohet sipas kësaj Kontrate do të gjykohet si e dërguar në mënyrën e duhur nëse ajo është dërguar në adresën e palëve shkruar në fillim, lart.

Kontrata e shitjes së kuotave, u lexua nga palët me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve, të cilët e kuptuan përmbajtjen e tij dhe meqenëse shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruan atë rregullisht.

Kjo Kontratë u redaktua në gjuhën shqipe në 3 (tre) ekzemplarë; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve.

**ORTAKU SHITËS**

**Florenc Gjiguria**



**ORTAKU BLERËS**

**Adrian Gjura**